



RAST STUDIMOR

# KORRUPSIONI PËRDITSHMËRIA JONË

SHTATOR 2023



## **PËRMBAJTJA**

Hyrje në shkaqet e korrupsionit	4
Një përmbledhje e shkurtër e metodologjisë	5
Parimi i funksionimit të komunave me shumicë serbe në Kosovë	6
Mekanizmat dhe modelet e korrupsionit	8
Tender për Shtëpinë e Shëndetit në Uglarë	9
Grantet për parandalimin e Covid-19 në Graçanicë	11
Lidhshmëria e shëndetësisë dhe arsimit përmes kuponëve	13
Konkluzione dhe rekomandime	15

Ky punim u botua në kuadër të projektit Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunat me shumicë serbe, i implementuar nga OJQ AKTIV dhe Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC) me mbështetjen financiare të Byroja Ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (International Narcotics and Law Enforcement Affairs Bureau - INL.) Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësia e vetme e OJQ-ve Aktiv dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e INL.

## Hyrje në shkaqet e korrupsionit

Korrupsioni sot më së shpeshti nënkupton përdorimin ose abuzimin e pushtetit shoqëror për përfitime personale. Megjithatë, kur flasim për korrupsionin në Ballkan, është ngjashëm sikur të flasim për zakone apo rituale. Dhënia e ryshfetit për t'u kthyer në një nder është diçka sikur "ashtu duhet", gjë që na e kanë lënë të parët tanë dhe korrektësia e së cilës nuk vihet në dyshim. Ashtu si çdo zakon tjetër, për ata që e vëzhgojnë nga anash, jashtë këtyre territoreve, mund të duket i çuditshëm, retrograd, madje edhe i neveritshëm. Gjithashtu, edhe ligjshmëria e një aktivitetit të tillë mund të vihet në pikëpyetje, si p.sh., prerja e fidanëve të rinj dhe të shëndetshëm të një peme në ditën e Krishtlindjeve, ose gjuajta me armë në mollë në dasma. Për Krishtlindje askush nga ne nuk shtron pyetjen nëse është marrë leje nga drejtorja e pylltarisë për prerjen e një peme të caktuar dhe nëse është siguruar mbjellja e pemëve të reja për të mos dëmtuar ekosistemin. Në rastin e zakonit të dasmës, nuk diskutohet nëse arma e përdorur për të qëlluar mollën është e regjistruar, nëse është në gjendje të rregullt dhe e sigurt, ku do të përfundojë plumbi në rënie, a mund të ketë lëndime e të ngjashme.

Mirëpo, si në çështjen e zakoneve ashtu edhe të korrupsionit, nuk vihet në dyshim ligjshmëria e veprimit, por veprimi pranohet si i tillë, i domosdoshëm dhe i pandryshueshëm, qoftë edhe me një dozë besëtytnie. Domethënë, nëse një punë kryhet pa korrupsion, mbetet një dozë mosbesimi ndaj zhvillimit dhe rezultatit pozitiv të saj. Nëse, për shembull, dikush është punësuar vetëm me konkurs, dhe jo me ryshfet paraprak të punëdhënësit, mbeten dyshime për qëndrueshmërinë e një punësimi të tillë. Operacioni në spital shtetëror ka shërim të sigurt nëse mjekut i ofrohet një zarf me para. Një veprim korruptiv është garancia e një kontrate pune të sigurt dhe afatgjate, një rezultat i sigurt dhe i caktuar i një procedure ose operacioni mjekësor, arritjes së lehtë të notës kaluese në fakultet dhe diplomës, ose ikjes nga drejtësia në gjykatë apo polici.

Kur flasim për korrupsionin si zakon në kontekstin e Kosovës, gjërat duket se shkojnë edhe përtej. Duke pasur parasysh se gjatë historisë Kosova nuk ka funksionuar asnjëherë në mënyrë të pavarur, por ka ekzistuar brenda një shteti më të madh apo mbretërie, ose si një territor nën protektorat, institucionet janë perceptuar si diçka e panjohur ndërsa afërsia me autoritete

<sup>1</sup> <https://www.danas.rs/zivot/obicaj-koji-je-krivicno-delo-zasto-se-na-svadbama-puca-u-jabuku/>

është përdorur gjithmonë për përfitime dhe prosperitet personal. Prandaj, mbizotëron qëndrimi se institucionet shërbejnë për t'u lajkatur nga "subjektet" e tyre, e të njëjtit për të siguruar përfitime u japin ryshfet zyrtarëve të tyre.

Një çerek shekulli pas përfundimit të konflikteve të fundit të armatosura dhe fillimit të vendosjes së demokracisë në Kosovë, në vend të ndërtimit të institucioneve zakoni i rrënjësor i minimumit dhe ryshfeteve nuk u zhduk. Ideja e lirisë nga represioni dhe rivendosja e demokracisë, e cila u mbështet me gjithë zemër nga shumica në komunitetin ndërkombëtar, nuk arriti të tejkalojë të metat dhe traditat kronike të një shoqërie të çrregullt. Rrënja e asaj tradite përbëhet nga korrupsioni, ende në një nivel shumë të lartë, kështu që punësimi në institucione ("puna shtetërore") është më i dëshirueshmi, gjë që nuk e ndan thelbësisht të ashtuquajturin "realitet të ri" në Kosovë nga i vjetri.

2 Isak Vorgučić, "Ključ - Studija o ključnim problemima kosovskih Srba", KFOS 2022, str. 9

## Një përmbledhje e shkurtër e metodologjisë

Metodat bazë të përdorura në përgatitjen e këtij studimi të shkurtër janë shqyrtimi i materialit të gjerë mediatik dhe artikujve gazetaresk, si dhe pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në jetën mediatike për më shumë se dy dekada. Përveç kësaj, janë marrë parasysh edhe përvojat e personave anonimë, si dhe materialet e pabotuara të redaksisë të cilat radio Kim dhe autori i kanë shqyrtuar. Në disa pjesë janë shfrytëzuar të dhënat e hulumtimit nga studimi i mëparshëm i autorit, i cili trajton problemet kryesore të serbëve të Kosovës.<sup>3</sup>

3 <https://kfos.org/srb/publikacije/118/key-study-key-problems-kosovo-serbs>

## Parimi i funksionimit të komunave me shumicë serbe në Kosovë

Pas kapitullimit dhe largimit të ushtrisë jugosllave dhe policisë serbe nga Kosova në qershor të vitit 1999, vetëm këto dy institucione u zëvendësuan menjëherë. Rolin e ushtrisë e mori NATO-ja në formë të KFOR-it, ndërsa policia, nën kujdesin e misionit ndërkombëtar të OKB-së të quajtur UNMIK, përbëhej nga policë profesionistë të rekrutuar nga vende të tjera evropiane dhe botërore. Përveç kësaj, zyrat lokale të UNMIK-ut u formuan me përfaqësues të caktuar ndërkombëtarë, që për detyrë kishin rolin e komunave. Megjithatë, të gjitha institucionet e tjera në zonat me shumicë serbe vazhduan me punën dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët kryesisht në lokacione të zhvendosura, duke përfshirë klinikat dhe spitalet, çerdhet, shkollat fillore dhe të mesme. Universiteti u zhvendos nga Prishtina në pjesën veriore të Mitrovicës, i vetmi qytet në Kosovë i cili, i mbrojtur nga lumi Ibër, arriti të ruante një numër të konsiderueshëm serbësh.

Pavarësisht nga insistimi i Prishtinës se në rastin e shëndetësisë dhe arsimit bëhet fjalë për “institucione paralele”, të njëjtat ende nuk e kanë paralelen e tyre apo “variantin kosovar” në zonat me shumicë serbe. Në ndërkohë, Kosova nuk ka shfaqur interesim dhe as nuk ka kapacitetet dhe resurse që pavarësisht nga ato ekzistuese të krijojë institucionet e veta shëndetësore dhe arsimore për serbët. Megjithatë, për këto qëllime janë ndarë mjete nga niveli qendror, të cilat do të diskutohen më vijim.

Ato që realisht vazhduan të funksionojnë paralelisht pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999, e sidomos pas vitit 2008 dhe obligimit kushtetues të Kosovës për formimin e komunave të reja me shumicë serbe, janë komunat e vjetra që veprojnë sipas sistemit serb. Ato ende përfshijnë territoret komunale të përcaktuara më parë, kështu që komuna e Mitrovicës nuk e ndan qytetin në pjesë jugore dhe veriore, kurse, për shembull, komuna e Prishtinës nuk e njej Graçanicën si komunë të veçantë sipas sistemit të Kosovës. Megjithatë, kur është fjala për punën e komunave në sistemin serb, është e rëndësishme të theksohen disa gjëra. Pas vitit 1999, në Kosovë nuk ka pasur zgjedhje lokale të organizuara nga Beogradi, kështu që pas skadimit të mandatit të udhëheqjes së mëparshme, në vend të tyre janë emëruar organe të përkohshme. . Këto emërimë përsëriten në mënyrë ciklike, por në pozitat kryesore të komunave qarkullojnë personat e njëjtë, gjithmonë të lidhur me partinë në pushtet.<sup>4</sup>

<sup>4</sup> <https://kossev.info/kadriranjje-u-po-iz-srbice-u-zvecan-lipljana-u-stimlje-stimlja-u-lipljan-kacani-ka-u-decane-k-polja-u-glogovac-glogovca-u-k-polje/>

Sa i përket ofrimit të shërbimeve, këto komuna kryejnë vetëm disa nga funksionet themelore në terren, të cilat shkurtimisht mund të përkufizohen si mbajtje e lidhjeve institucionale me Beogradin. Për shkak të mungesës së lidhjeve me sistemin e Kosovës dhe vështirësive në marrjen e lejeve të nevojshme lokale, shumica dërrmuese e projekteve kapitale, mirëmbajtja e infrastrukturës dhe zgjidhja e problemeve aktuale në komuna në zonat me shumicë serbe janë ndërmarrë nga komunat e Kosovës.

Serbët në gjashtë komuna në pjesën jugore të Kosovës<sup>5</sup> morën pushtetin lokal në zgjedhjet e vitit 2009, mbajtja e të cilave u kundërshtua nga Beogradi<sup>6</sup>, ndërsa katër komuna<sup>7</sup> në veriun etnikisht kompakt, e bënë këtë me mbështetjen e autoriteteve serbe vetëm në vitin 2014. Kësaj i parapriu Marrëveshja e Brukselit<sup>8</sup>, me të cilën Beogradi mori përsipër të integronte serbët nga veriu në sistemin e Kosovës, ndërsa në këmbim serbët përmes Asociacionit të Komunave me shumicë serbe duhej të merrnin një shkallë më të madhe të autonomisë dhe lidhjes me Beogradin. Me këtë ndërhyrje të autoriteteve serbe, me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, praktikisht në Kosovë u shfuqizua pluralizmi politik në mesin e serbëve dhe Lista Serbe, e menaxhuar drejtpërdrejt nga Beogradi, u imponua si përfaqësuese ekskluzive dhe e vetme e serbëve të Kosovës.

<sup>5</sup> Shtërpcë, Kllokot, Partesh, Ranilug, Novobërdë dhe Graçanicë

<sup>6</sup> <https://www.dw.com/sr/nesloga-srba-pred-kosovske-izbore/a-4892812>

<sup>7</sup> Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zveçan dhe Zubin Potok

<sup>8</sup> <https://www.srbija.gov.rs/cinjenice/283757>

## Mekanizmat dhe modelet e korrupsionit

Të dy sistemet në të cilat jetojnë dhe punojnë serbët e Kosovës kanë përparësitë e tyre. Ndonëse shkollohen në Kosovë, pas përfundimit të shkollimit, nxënësit mund në mënyrë të rregullt të regjistrohen në shkallë më të lartë shkollimi kudo në Serbi, ose të ndryshojnë shkollën gjatë shkollimit të tyre dhe diplomat e këtyre institucioneve arsimore t'ju njihen kudo në botë.<sup>9</sup> Gjithashtu, udhëzimet nga komisionet mjekësore apo recetat për barna janë të vlefshme për të gjitha institucionet shëndetësore në Serbi, ndërsa sipas nevojës pacientët transportohen aty ku është e nevojshme për ndërhyrje dhe terapi. Sa i përket shërbimeve të ofruara nga komunat sipas sistemit serb, për shembull, mund të merrni një certifikatë të statusit pronësor, ose dokumente të ngjashme që nevojiten për zgjidhjen e çështjeve administrative kudo në Serbi.

<sup>9</sup> Përveç në Kosovë

Gjithashtu duhet theksuar se pas vitit 2014 dhe marrjes së primatit politik nga Lista Serbe, kufijtë mes sistemit “serb” dhe “kosovar” në nivel lokal dalëngadalë po fshihen dhe këto dy sisteme po ndërthuren me njëri-tjetrin. Duhet theksuar<sup>10</sup> se nënkryetari aktual i komunës së Graçanicës sipas sistemit kosovar, Millan Joksimoviq, është edhe kryetar i organit të përkohshëm të komunës së Lipjanit sipas sistemit serb. Lubinko Karaxhiq, derisa ishte kryetar i organit të përkohshëm të Komunës së Prishtinës (në Graçanicë), njëkohësisht ka mbajtur pozitën e nënkryetarit të komunës së Graçanicës sipas sistemit kosovar. Alleksandar Spiriq, përderisa ishte kryetar i organit të përkohshëm të komunës së Mitrovicës sipas sistemit serb, nga viti 2020 mori edhe pozitën e ushtruesit të detyrës së kryetarit të Mitrovicës së Veriut sipas sistemit kosovar, ndërsa kryetari shumëvjeçar i komunës së Shtërpçës sipas sistemit kosovar, Bratisllav Nikolliq, në një moment e mori edhe pozitën e kryetarit të organit të përkohshëm të komunës së Ferizajt (në Shtërpçë).

Fshirja e kufijve ndërmjet dy sistemeve në nivel lokal ka si parakusht fshirjen e kufijve politikë ndërmjet udhëheqësve të tyre, që i përkasin partive në pushtet të serbëve në Kosovë dhe Serbi, ndërsa një nga arsyet kryesore për një partneritet të tillë është mundësia e shfrytëzimit të buxhetit dhe ushtrimit të ndikimit në terren. Siç u theksua më herët, përveç buxhetit për projekte kapitale, komunat e Kosovës kanë edhe autoritetin de facto të zbatimit të këtyre projekteve, marrjen e lejeve të nevojshme dhe mbrojtjen ligjore të institucioneve në nivel qendror. Nga ana tjetër, ato buxhete pushojnë së dedikuari ekskluzivisht për qytetarët dhe fillojnë të drejtohen si ndaj pjesëtarëve partiakë, ashtu edhe ndaj votuesve.

<sup>10</sup> Isak Vorgučić, “Ključ - Studija o ključnim problemima kosovskih Srba”, KFOS 2022, str. 32



## Tender për Shtëpinë e Shëndetit në Uglarë

Në nivelin e lartë të komunave dhe drejtorive komunale, shumica e mjeteve për partinë kanalizohen përmes tenderëve. Një shembull i tillë është tenderi për përfundimin e ndërtimit të Shtëpisë së Shëndetit në fshatin Uglarë të Fushë Kosovës<sup>11</sup>. Gjegjësisht, shërbimet shëndetësore në këtë vend deri në vitin 2021 ofroheshin nëpër shtëpi private, derisa ndërtimi i objektit të ri i cili filloi në vitin 2007 përfundoi vetëm pas 14 vitesh. Në atë kohë, punimet ishin ndërprerë qysh në fillim për shkak se Komuna e Fushë Kosovës sipas sistemit kosovar, e cila është e përbërë kryesisht nga shqiptarë dhe në përbërjen e së cilës në atë kohë ishte edhe fshati Uglarë, nuk ka dashur t'i lëshojë leje ndërtimi një institucioni serb.

Pas vitit 2009, fshati Uglarë sipas sistemit kosovar administrativisht i kaloi komunës së sapoformuar të Graçanicës me popullsi kryesisht serbe, ndërsa sipas sistemit serb mbetet pjesë e komunës serbe të Fushë Kosovës. Për të përfunduar punimet në objektin në fjalë, paratë janë alokuar nga Zyra për Kosovë dhe Metohi me seli në Beograd, ndërsa tenderi është shpallur nga komuna e Zveçanit sipas sistemit serb. Tenderin e ka fituar kompania ndërtimore "Rad 028", e cila gjithashtu është nga Zveçani, dhe të njëjtën mediat<sup>12</sup> e ndërlidhin me Millan Radoiqiqin, nënkryetarin e Listës Serbe dhe njeriun me të kaluar kriminele<sup>13</sup>. Leja e ndërtimit këtë herë nuk ka qenë problem, marrë parasysh se edhe komuna kompetente e Graçanicës sipas sistemit kosovar është në duart e Listës Serbe.

Mbetet e paqartë se mbi çfarë baze komuna e Zveçanit mund të shpallë tender për kryerjen e punimeve në komunën e Fushë Kosovës, e cila është rreth 50 kilometra larg. Pronari i kompanisë ndërtimore Radulle Steviq, i cili ishte në listën e zezë të Departamentit të Financave të SHBA-së<sup>14</sup>, me rastin e fitimit të punës për përfundimin e punimeve, para gazetarëve ka sqaruar se kjo ka ndodhur për shkak se komuna e Fushë Kosovës nuk ka kapacitet që të shpallë tender e vetme. Mirëpo, kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, Lubisha Qirkoviq, në komentin e tij ka shtuar "Nuk është logjike dhe nuk e di pse veprojnë kështu, por ata më së miri e dinë."<sup>15</sup> Rrallë ndodhë që një deklaratë e tillë të arrijë në opinion, por kjo dëshmon qartë se institucionet lokale, të cilat drejtohen nga serbët në Kosovë, shpeshherë i kanë duart e lidhura kur bëhet fjalë për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të alokuara për to.

<sup>11</sup> <https://www.radiokim.net/vesti/drustvo/ima-li-kraja-gradnji-objekta-za-srpske-institucije-u-ugljaru.html>

<sup>12</sup> <https://www.facebook.com/ninonline/posts/2375036695899997/>

<sup>13</sup> <https://www.slobodnaevropa.org/a/kosovo-milan-radoicic-posao/32236115.html>

<sup>14</sup> <https://www.slobodnaevropa.org/a/kosovo-americka-crna-lis-ta-radule-stevic/32523073.html>

<sup>15</sup> <https://www.radiokim.net/vesti/drustvo/ima-li-kraja-gradnji-objekta-za-srpske-institucije-u-ugljaru.html>

Kompania ndërtimore në fjalë “Rad 028” është pak e njohur për opinionin, ndërsa në faqen e Agjencisë e Regjistrimit të Bizneseve në Serbi thuhet se është themeluar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në vitin 2014, me kapital prej 1000 dinarësh. Sipas raportimeve të mediave, në periudhën deri në vitin 2018, për vetëm katër vite ekzistencë, kjo kompani ka fituar 72 tenderë të shpallur nga komunat serbe në veri të Kosovës, përkatësisht Zyra për Kosovë dhe Metohi e Qeverisë së Serbisë. Vlera e të gjitha atyre punimeve është më shumë se 700 milionë dinarë ose rreth gjashtë milionë euro<sup>16</sup>.

Numri i tenderëve që kanë marrë kompanitë e afërta me kryesinë e Listës Serbe në komunën e Graçanicës nuk dihet, por për opinionin publik është i njohur fakti se kryetarja e komunës, Lilana Shubariq, me rastin e shënimit të ditës së komunës në vitin 2022, i dërgoi Millan Radoiçiqit një letër falënderimi si “në individ i shquar, për merita të veçanta”. Letrën falënderuese në emër të nënkryetarit të Listës Serbe, Radoiçiq, i cili atë mbrëmje nuk ishte në Graçanicë, e as që nga mandati i Shubariqit si kryetare e komunës, e pranoi zëdhënësi i Listës Serbe, Igor Simiq.<sup>17</sup>

Në një bisedë me pronarin e kompanisë ndërtimore të njohur për autorin, mësojmë gjithashtu se si ofertuesit dhe fituesit e tenderit fitojnë para shtesë. Kështu, duke i “fryrë” çmimet blerëse të materialeve ndërtimore deri në dy herë, një pjesë e mjeteve të marra i kthehen ofertuesit, i cili në të njëjtën kohë mbetet “i mbuluar” me letra. Për të mbajtur njohuri për aktivitete të tilla brenda një rrethi më të vogël njerëzish, tenderët fitohen nga të njëjtat kompani, zakonisht me lidhje të ndërsjella partiake dhe kriminele<sup>18</sup>. Ndërtesat e ndërtuara, kryesisht shtëpitë për të kthyerit, shpesh ndërtohen për personat që as nuk jetojnë në Kosovë ose që tashmë e kanë zgjidhur çështjen e banimit dhe për këtë arsye nuk vendosen kurrë në to, por ndërtesat e përfunduara shiten ose u jepen me qira palëve të treta.

<sup>16</sup> <https://www.facebook.com/ninonline/posts/2375036695899997/>

<sup>17</sup> <https://www.radiokim.net/vesti/drustvo/da-gracanica-bude-mestu-u-koje-se-vise-dolazi-nego-odlazi.html>

<sup>18</sup> [https://home.treasury.gov/news/press-releases/jy0519?fbclid=IwAR1451\\_JddIHfQF9CeoasVgZ-t0QurNN1HR3Tjrn-CRrXTNuBurs-FK1C7lUk](https://home.treasury.gov/news/press-releases/jy0519?fbclid=IwAR1451_JddIHfQF9CeoasVgZ-t0QurNN1HR3Tjrn-CRrXTNuBurs-FK1C7lUk)

## Grantet për parandalimin e Covid-19 në Graçanicë

Këshilltarët e Kuvendit Komunal të Graçanicës, në vllugun e pandemisë së koronavirusit, në fund të nëntorit 2020, me qëllim të realizimit të projekteve që synojnë “parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 dhe zbutjen e pasojave të tij”<sup>19</sup> miratuan propozimin për ndarjen e mjeteve financiare për 14 organizata joqeveritare. Komuna e Graçanicës dispononte me mjete financiare në vlerë prej afro 285 mijë euro, të siguruar nga Qeveria e Kosovës si pjesë e masave ekonomike për rimëkëmbjen gjatë pandemisë. Thirrjes publike të komunës i janë përgjigjur 14 organizata joqeveritare nga Graçanica dhe për të gjitha këto organizata janë miratuar mjete identike – për secilën nga 20.356,11 euro.

Komisioni për ankesa, pavarësisht kundërshtimit të disa këshilltarëve, ka marrë vendim që procedura u zhvillua në mënyrë të ligjshme, mirëpo ndryshimet e caktuara kanë ndodhur vetëm pas reagimit të mediave<sup>20</sup>. Edhe pse këshilltarët komunal e mbështetën vendimin në bazë të një dokumenti që thoshte se organizatat do të merrnin të njëjtën shumë parash, pak ditë më vonë u shfaq një dokument i ri me shuma tjera, të ndryshme. Dushan Borisavleviq, anëtar i komisionit komunal, lidhur me atë rast deklaroi se ishte bërë një gabim teknik dhe se fillimisht ishte publikuar draft versioni i dokumentit.

Krahas problemeve me shumën e mjeteve, në disa raste ka pasur edhe konflikte interesi. Një nga themeluesit e organizatës që fitoi grantin ishte vetë kryetari aktual i komunës Srgjan Popoviq. Drejtori i kadastrit, Nebojsa Periq, është regjistruar si person kontaktues i organizatës që po ashtu ka marrë grantin, ndërsa anëtar i organizatës së tretë fituese është zyrtari i komunës Sllobodan Kostiq. Borisavleviq, anëtar në fjalë i komisionit, i pyetur nga një gazetar për këto pretendime lidhur me konflikt interesi, tha: “Ndoshta, dhe jam dakord me faktin se disa nga themeluesit tani janë në pozita ose kanë të bëjnë diçka me komunën, por, sipas dijenisë sime, në punën e organizatave drejtpërdrejt nuk është i përfshirë askush.”<sup>21</sup>

Pas presionit njëmuor nga mediat dhe mospajtimeve mes kryesisë komunale dhe komisionit për ndarjen e granteve, u bë e ditur se të katërmbëdhjetë organizatat kishin dërguar kërkesë për anulimin e vendimit. Përveç rastit të OJQ “Qendra për Paqe

<sup>19</sup> <https://www.radiokim.net/vesti/drustvo/podrska-nvo-projekti-ma-da-se-novac-ne-bi-vratio-u-budzet.html>

<sup>20</sup> <https://www.radiokim.net/vesti/drustvo/kako-su-i-kojim-nvo-dodeljena-finansijska-sredstva.html>

<sup>21</sup> Ibid

dhe Tolerancë” (Centar zam ir i toleranciju), e cila kërkesën e ka dorëzuar edhe në media, mbetet e panjohur se si organizatat e tjera kanë hequr dorë nga konkursi. Përveç kësaj, për opinionin veprimtaria e shumë organizatave që kanë aplikuar është e panjohur, kurse shumica e përfaqësuesve të tyre ose janë të afërt me drejtuesit e komunës së Graçanicës, si të afërm, miq dhe partiak, ose janë të punësuar në këtë institucion.<sup>22</sup> Megjithatë, komuna e Graçanicës në faqen e saj zyrtare ka shpallur vendimin për anulimin e thirrjes publike, me arsyetimin se “OJQ-të kanë hequr dorë nga nënshkrimi i kontratës dhe ndarja e mjeteve”, dhe si rrjedhojë mjetet janë kthyer në buxhetin e Kosovës.

Edhe në nivelin qendror të Kosovës kemi veprime të ngjashme, siç është rasti i fundit i shpërndarjes së granteve nga Zyra për Çështje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Grantet në vlerë të përgjithshme prej 500 mijë eurosh janë shpërndarë nga komisioni i kësaj Zyre për 42 organizata jo-qeveritare, prej të cilave vetëm 3 janë të komunitetit serb. Më shumë se 90 për qind e mediave dhe OJQ-ve të cilave u janë ndarë fondet vijnë nga komuniteti shumicë shqiptar dhe disa nga përfituesit e fondeve nuk mund të gjenden as në regjistrin publik të OJQ-ve<sup>23</sup>. Elizabeth Gowing, ushtruesja e detyrës së drejtoreshës së kësaj zyre në atë kohë, dha dorëheqje, duke deklaruar se ishte “e zhgënjyer nga fakti që një numër i vogël i OJQ-ve dhe mediave të përzgjedhura për mbështetje financiare përfaqësojnë në fakt organizata të themeluara nga ndonjë komunitet jo-shumicë”.

<sup>22</sup> Ibid

<sup>23</sup> <https://www.radiokim.net/vesti/politika/ostav-ka-na-posao-u-kancelariji-za-pitanja-zajednica-zbog-rezultata-konkursa.html>

## Lidhshmëria e shëndetësisë dhe arsimit përmes kuponëve

Siç është theksuar tashmë, punëtorët shëndetësor dhe të arsimit në mjediset me shumicë serbe në Kosovë punojnë nën autoritetin e ministrive në Beograd, dhe si të tillë e kanë të sigurtuar të ashtuquajturën shtesën për Kosovë, e cila është një bonus në pagën bazë në vlerë prej 50%. Përveç këtyre të ardhurave, një pjesë e personelit mjekësor dhe shkollor nga ministritë në Prishtinë marrin edhe një kompensim mujor, të ashtuquajtur “kuponë” (vauçer). Kështu<sup>24</sup>, Ministria e Shëndetësisë e Kosovës, e cila është përgjegjëse për të gjitha institucionet shëndetësore, nuk është përgjegjëse për tri komuna me shumicë serbe: Mitrovicën e Veriut, Graçanicën dhe Shtërpçën, komuna të cilat janë të përfshijtura nga ky rregullim i përgjithshëm institucional. Këto tri komuna, përveç kompetencave të nivelit të kujdesit primar, menaxhojnë edhe ofrimin e kujdesit sekondar shëndetësor. Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, kompetencat e zgjeruara të këtyre komunave përfshijnë të drejtën për pagat e personelit shëndetësor dhe administratorëve të kujdesit shëndetësor<sup>25</sup>. Në mënyrë të ngjashme, komunat disponojnë edhe me honorarët e punëtorëve arsimorë, që paguhen në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës (MASHTI).

Marrë parasysh që komunat nuk ofrojnë të dhëna transparente për pagesa, numri i saktë i personave në këto lista nuk dihet ndërkaq ata që janë në listat e pagesave lidhur me këtë nuk duan të flasin. Mirëpo, nga bisedat anonime me të punësuarit, mund të kuptojmë se bëhet fjalë për një numër më të vogël të “privilegjuarve”, kryesisht për personel drejtues, profesorë, drejtorë apo mjekë. Kështu shpërblehen për bindjen dhe besnikërinë e tyre ndaj partisë, si dhe për ndikimin ndaj kolegëve të tyre vartës dhe stafit tjetër me rastin e votimit në zgjedhje. Këtë e mbështet shembulli i organit të përkohshëm të komunës së Mitrovicës, i cili “ftoi drejtorët e ndërmarrjeve publike komunale që të votojnë me punëtorët dhe familjarët e tyre dhe në vendvotime të shkojnë në mënyrë të organizuar”<sup>26</sup>.

Komunat gjithashtu u japin kuponë individëve të papunë, duke blerë kështu besnikërinë e tyre, në mënyrë që këta, përveç punës në institucione shëndetësore e arsimore, të punojnë në sigurimin votave të sigurta nga shtresat më të gjera dhe më të varfra të popullsisë. Të shpeshta janë edhe rastet e nepotizmit, kur udhëheqësit e komunave u paguajnë honorarë të tillë personave sipas linjës familjare që nuk jetojnë fare në Kosovë<sup>27</sup>.

<sup>24</sup> Isak Vorgučić, “Ključ – Studija o ključnim problemima kosovskih Srba”, KFOS 2022, str. 20

<sup>25</sup> Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, i miratuar në vitin 2008, <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

<sup>26</sup> <https://www.blic.rs/vesti/politika/vece-organizova-no-glasanje-u-severnoj-mitrovici-u-nedelju/rx8eyyq>

<sup>27</sup> <https://www.radiokim.net/vesti/drustvo/protest-u-vrbovicu-se-nastavlja-predsednik-ops-tine-bezi-od-gradjana-i-novinar.html>

Pagesa e honorarëve për punëtorët e shëndetësisë dhe arsimin nga institucionet e Kosovës përmes kuponëve mund të paraqesë një përpjekje të Prishtinës për të shprehur më shumë interesim për këto institucione, por në praktikë janë një instrument me të cilin komnatat i shpërblejnë pasardhësit e tyre ose blejnë vota në zgjedhje<sup>28</sup>.

<sup>28</sup> Isak Vorgučić, "Ključ - Studija o ključnim problemima kosovskih Srba", KFOS 2022, str. 33

## Konkluzione dhe rekomandime

Në këtë studimor janë cekur vetëm disa shembuj, që padyshim janë shembuj të korrupsionit dhe abuzimit me funksionet publike për përfitime personale, e që në praktikën e përditshmërisë kemi shembuj të panumërt të veprimeve të tilla. Shpenzimi i buxheteve të qytetarëve sipas linjave partiake nuk është diçka e panjohur as në komunat me shumicë shqiptare në Kosovë, dhe kemi rastin e fundit kur Qeveria, e cila përbëhet nga anëtarë të Vetëvendosjes, ka ndarë 2 milionë euro ose një të katërtën nga totali i mjeteve për projekte në katër komuna në të cilat partiakët e tyre janë kryesues të kuvendeve<sup>29</sup>. Përveç kësaj, shpesh ndodh që serbët dhe shqiptarët të marrin pjesë dhe të bashkëpunojnë së bashku në akte të mëdha korrupsioni<sup>30</sup>, gjë që e bën më të lehtë mbrojtjen dhe mbulimin e njëri-tjetrit, sepse barrierat etnike janë ende të larta në Kosovë.

Bazuar në sa më sipër, ajo që mund të shihet si mangësi kryesore e kësaj mënyre të funksionimit të institucioneve në zonat me shumicë serbe është jotransparenca, mungesa e kontrollit dhe mundësia e shmangies së përgjegjësisë. E gjithë kjo e bën mjaft të sigurt zbatimin e korrupsionit kurse luftimi i tij është në kufirin e së pamundurës. Korrupsioni është një problem me të cilin jetojmë dhe të cilin sigurisht do ta hasim shpesh në të ardhmen, mirëpo që Kosova të fillojë të ofrojë kushte për luftimin e korrupsionit në komunat me shumicë serbe, është e nevojshme:

- Të bëhet shtypja sistematike e korrupsionit kryesisht në nivelin qendror në Prishtinë, duke krijuar parakushte ligjore dhe morale për nxitje të hetimeve dhe veprimeve kundër korrupsionit në komunat me shumicë serbe, pa frikë se do të interpretohen si të drejtuara kundër serbëve.
- Të fuqizohen autoritetet për kontrollin e transparencës së punës së komunave, proporcionalisht dhe njëkohësisht në zonat me shumicë shqiptare dhe serbe.
- Të formohet Asociacioni i Komunave me shumicë serbe sipas marrëveshjeve të pranuar më parë, përmes të cilave do duhej që:
  - ▶ Qeveria e Kosovës, mbi të gjitha, të tregoj se kujdeset për cilësi më të mirë të jetës dhe për të drejtat e njeriut dhe të pakicave të serbëve të Kosovës.

<sup>29</sup> [https://kallxo.com/lajm/qeveria-kurti-ndan-2-milion-euro-per-komunat-cer-eku-shkon-per-ato-te-lvv-se/?fbclid=IwAR2xcNFgUc7Uin8C-nEwFnIac8tS\\_Vz2DKW2l184F-sHJ-e1QmEc\\_0oT9-Ypc](https://kallxo.com/lajm/qeveria-kurti-ndan-2-milion-euro-per-komunat-cer-eku-shkon-per-ato-te-lvv-se/?fbclid=IwAR2xcNFgUc7Uin8C-nEwFnIac8tS_Vz2DKW2l184F-sHJ-e1QmEc_0oT9-Ypc)

<sup>30</sup> <https://n1info.rs/vesti/novinar-gasi-o-hapsenjima-u-strpcu/>

- ▶ Të krijohen lidhje më të mira të serbëve me institucionet në nivelin qendror të Kosovës dhe të legalizohen lidhjet e nevojshme me institucionet e Serbisë që ofrojnë shërbime për qytetarët (arsimi, shëndetësia, ndërmarrjet publike).
- ▶ Të sigurohet krijimi i mekanizmave dhe organeve të nevojshme që do garantojnë veprimtarinë transparente të Asociacionit si ndaj Prishtinës ashtu edhe ndaj Beogradit, me çka edhe do të zvogëlohet hapësira për praktika korruptive. Beogradu, çime bi se smanjio prostor za koruptivne radnje.

Në mënyrë që Serbia, në anën tjetër, të sigurojë shtypjen e korrupsionit në zonat me shumicë serbe në Kosovë, do të ishte e nevojshme që të ketë një gjyqësor dhe polici funksionale si mbështetje në terren, edhe pse policia në sistemin kosovar u integrua në vitin 2014 ndërsa gjyqësori në vitin 2017. Përpos që këto parakushte nuk ekzistojnë, Beogradi nuk ka as vullnet e as synim që të sigurojë punën e drejtë dhe të ligjshme të institucioneve të tij. Sistemi njëpartiak që kontrollon punësimin në sektorin publik, si në Serbi ashtu edhe në zonat me shumicë serbe në Kosovë, ka si parakusht bindjen partiake, mbi të gjitha të personelit drejtues në institucione, që mandaton fuqinë punëtore dhe detyron që burimet e tyre të vihen në dispozicion të partisë sa herë që është e nevojshme. Fakti që puna e tyre është larg syve të publikut në Serbi, si dhe ndjenja e përgjithshme ndaj serbëve të Kosovës, e cila është në rënie e sipër, por ende mbizotëron, përdoret si një mundësi që, nën maskën e gjoja patriotizmit dhe "ruajtjes së integritetit territorial dhe sovranitetit e vendit"<sup>31</sup>, të fsheh veprimet e paligjshme sipas çdo sistemi.

Duke supozuar se Beogradi në një moment do të ishte i gatshëm t'i bashkohet luftës kundër korrupsionit në zonat me shumicë serbe në Kosovë, do të ishte e nevojshme:

- > Të parandalohet targetimi dhe parandalimi i formimit, veprimit dhe punës së individëve dhe partive politike në mesin e serbëve të Kosovës që kanë program dhe qëndrim politik të ndryshëm nga Lista Serbe.
- > Opcionale, t'i mundësohet Listës Serbe që të fillojë të funksionojë si një organizatë që do të bashkonte opinione të ndryshme politike dhe individë, do të nxiste dialogun demokratik brendapartiak dhe zgjedhjen e pavarur të përfaqësuesve të saj, pa ndikimin e Beogradit. Qëllimi i kësaj do të ishte veprimi i përbashkët i të gjithë serbëve të Kosovës për përfaqësim në zgjidhjen e problemeve, në mbajtjen e nevojshme dhe të natyrshme të lidhjeve me Beogradin, por jo si me një qendër që jep vetëm direktiva.

<sup>31</sup> <https://insajder.net/emisije/serijali/patriotskapljacka>



- Për qëllim të ofrimit të shërbimeve për bashkatdhetarët tanë, të bëjmë përpjekje drejt fillimit të bashkëpunimit me institucionet e Kosovës, që si parakusht do të kishte ndërprerjen e retorikës nxitëse dhe përçmimit.
- Të ofrohet mbështetje maksimale për Prishtinën, nëse është e nevojshme me ndërmjetësim të komunitetit ndërkombëtar, për formimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe, në një mënyrë që do të ishte më e dobishme për të gjitha palët e përfshira.
- Të marrë pjesë dhe të inkurajojë krijimin e lidhjeve më të mira të serbëve të Kosovës me institucionet në nivelin qendror të Kosovës.
- Të krijohen parakushte ligjore në nivel të Serbisë për bashkëpunim dhe ndihmë të papenguar ndaj Asociacionit që të vazhdohet puna e institucioneve që ofrojnë shërbime për qytetarët (arsimi, shëndetësia, ndërmarrjet publike).
- Të mbështetet krijimi i mekanizmave dhe autoriteteve të nevojshme për kontrollin e transparencës së punës së Asociacionit që do të zvogëlonin hapësirën për praktika korruptive.
- Të mundësohet krijimi i besimit dhe bashkëpunimit të autoriteteve policore dhe gjyqësore me autoritetet përkatëse në Kosovë, me qëllim të koordinimit të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Fatkeqësisht, në bazë të njohjes së mirë të situatës dhe shenjave qartësisht të dukshme, është e sigurt se korrupsioni është diçka që sigurisht për një kohë të gjatë do të jetë një problem me të cilin do të përballemi. Është i pazakontë vetëm për ata që e vëzhgojnë nga anash, pra për ata nga këto zona që i rezistojnë pavarësisht gjithçkaje dhe për ata që vijnë nga vende demokratike dhe ligjërish të rregulluara. Megjithatë, tek ne bëhet fjalë për vetëm një zakon më shumë: kur festohet pihet deri në mpirje dhe kur aplikohet për tender një përqindje për ryshfet është paraparë. Kush nuk dehet në festë, dhe kush nuk ofron kompensim për një shërbim publik, nuk i takon atyre “normalë”, ndërsa kush pa diskutim i pranon këto zakone, pavarësisht kombësisë dhe fesë, konsiderohet “një prej nesh”.

